

VENDIM
Nr. 611, datë 31.8.2016

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT PRIVAT TË
ARSIMIT TË LARTË “ISSAT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit privat të arsimit të lartë “ISSAT”, Tiranë, të të gjitha njësive përbërëse të tij dhe mbylljen e të gjitha detyrimeve lidhur me veprimtarinë mësi-more shkencore në të gjitha ciklet e studimit ku ushtron veprimtarinë.

2. Institucioni privat i arsimit të lartë “ISSAT”, Tiranë, të arkivojë të gjithë dokumentacionin mësimor, administrativ dhe financiar, në Arkivin e Shtetit, në përputhje me kuadrin ligjor mbi arkivat, brenda një kohe sa më të shpejtë.

3. Vula e institucionit privat të arsimit të lartë “ISSAT” të asgjësohet sipas procedurave të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi.

4. Të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për mbylljen e këtij institucioni privat të arsimit të lartë, në zbatim të këtij vendimi, të përballohen nga ana e institucionit privat të arsimit të lartë/personit juridik privat që i përfaqëson. Institucioni privat i arsimit të lartë “ISSAT” duhet të kthejë pagesat e kryera nga studentët për pjesën e papërfunduar të programeve përkatëse të studimit, për rastet kur pagesat janë kryer për cikël studimi dhe çdo detyrim tjetër të papërmbytur që mund të kenë ndaj studentit.

5. Për studentët, që nuk kanë përfunduar programet përkatëse të studimit, institucioni privat i arsimit të lartë “ISSAT” të përgatitë dosjen për çdo student, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit të lartë për vazhdimin e studimeve dhe t’ia vëre atë në dispozicion vetë studentit pa asnjë detyrim financiar shtesë nga ana e tij, brenda një kohe sa më të shpejtë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra Kombëtare e Biznesit, Arkiva e Shtetit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, si dhe institucioni privat i arsimit të lartë “ISSAT” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama